



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, më 06.11.2019

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 155, datë 06.11.2019 “Mbi shpalljen e konkursit për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2019 – 2020, ne Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **06.11.2019 deri më 12.11.2019**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

I. Departamenti i Veprimtarisë Fizike Rekreative dhe Turizmit

- **Sporte në Natyrë** (Moduli: Sporte Ujore-Not (Bachelor) 2 (dy) As/Lektor, Lektor
- **Turizëm** (Moduli: Kamping Veror Malor (Bachelor) 3 (tre) As/Lektor, Lektor

II. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë si më poshtë:

- Të jetë diplomuar në specialitetin e lëndës përkatëse ku konkuron.
- Të ketë së paku gradën Master Shkencor për mësimdhënie ne Ciklin e Parë Bachelor.
- Për aplikantët me gradë Master i Shkencave:
 - Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze-me dëshmi)
- Preferohen kandidatët me titullin “Doktor i Shkencave “
- Preferohen aplikantët që kanë eksperiencë të mësimdhënies në IAL
- Vlerësohen kualifikime të ndryshme të detyrueshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës ku aplikon
- Të ketë veprimtari shkencore si referime, botime ose studime.

III. Të interesuarit duhet të dërgojnë me anë te shërbimit postar në protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)

- ✓ Numrin e llogarisë bankare (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t'u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR – UST (nqse është i punësuar)
- ✓ Vetëdeklarim në rast se është i/e papunësuar
- ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

- IV. Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- V. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **moduli ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.
- VI. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron CUKA